


# Komuna e Kaçanikut, pa femra në poste udhëheqëse Zvicra investon në fuqizimin e grave kaçanikase në vendimmarrje



KOHA  
DITËS

EKREM RAKA

KAÇANIK, 7 NËNTOR - Femrat nuk figurojnë si bartëse të asnjërit nga postet udhëheqëse të ekzekutivit dhe legjislativit të Kaçanikut, ndërsa ky fakt "e ka detyruar" Qeverinë zvicerane të investojë për fuqizimin e gruas së këtushme në vendimmarrje. "Projekti Zvicër - Kosovë për qeverisje lokale dhe decentralizim - LOGOS, që financohet nga Qeveria zvicerane dhe zbatohet nga 'Helvetas Intercooperation', është përcaktuar për ta financuar projektin: 'Fuqizimi i gruas në procesin e vendimmarrjes', ka theksuar Vedat Dema, zyrtar për barazi gjinore i KK të Kaçanikut. Ai ka sqaruar se zbatimi i projektit do të zgjasë 1 vit. "Projekti parasheh mbajtje tryezash debatuëse dhe ligjëratash, pastaj avokime etj.", ka thënë Dema. Për realizimin e projektit të sipërpërmendur LOGOS-i i kishte alokuar 7 mijë euro. Kaçaniku është njëra nga 9 komunat e Kosovës juglindore partnere të projektit të sipërpër-

mendur të Qeverisë zvicerane. Është thënë se LOGOS-i me nga 7 mijë euro i ka mbështetur edhe projektet për barazi gjinore të 8 komunave të tjera, ndërsa me nga 2 mijë euro zyrat e informimit publik. Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës së Kaçanikut, të hënën, e ka cituar koordinatoren e LOGOS-it, Norbert Piljs, të ketë deklaruar më herët se Qeveria zvicerane është e interesuar që fondet e saj t'i shpenzojë për zhvillimin e demokracisë lokale dhe në këtë kontekst LOGOS-i mbështet projektet që kanë të bëjnë me avancimin e punës së zyrave të informimit publik dhe atyre për barazi gjinore. "Avancimi i punës së zyrave të informimit publik dhe i punës së atyre për barazi gjinore është me rëndësi për LOGOS-in, ndërsa këto zyra dhe OJQ-të që mbështeten me këto fonde do t'i shpenzojnë mjetet aty ku e shohin më të arsyeshme dhe ku nevojat janë më të mëdha", është cituar të ketë thënë Piljs në takimin e paradoditshëm me zyrtarët e komunave partnere.